

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 04 —————>

TETOR 2021



RINGJALLJE
INVESTIM
MBËSHTETJE
QËNDRUESHMËRI
KOORDINIM
PUNËSIM
MIRËQENIE
BARAZI
JETËSIM
EKONOMI

Masa 2 → Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

Për buletinin

Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është publikim mujor i Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, përmes të cilit synohet informimi në detaje i qytetarëve të Kosovës rreth zbatimit të masave që i përmban Pako e Ringjalljes Ekonomike. Masat e integruara në këtë pako kanë për qëllim lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike, dhe tejkalimin e problemeve që shkaktoi kjo pandemi, tek qytetarët dhe bizneset. Prandaj rëndësia e kësaj pako në rimëkëmbjen ekonomike të vendit është shumë e madhe.


Ky edicion i buletinit, i katërti me rradhë, do të shtjellojë dhe do të ofrojë informacione shtesë përfshirë këtu edhe analiza sa i përket masës së dytë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Kjo masë titullohet Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit dhe ka gjithsej të ndara **108 milionë Euro** për mbështetjen e këtyre sektorëve. Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është i realizuar në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID.

→ ÇFARË OFRON MASA E DYTË E PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE?

Që nga data 13 mars 2020, kur u konfirmua paraqitja e dy rasteve të para të të infektuarve me virusin COVID-19 në Republikën e Kosovës, e deri më sot, sektori ekonomik dhe veçmas sektori prodhues kanë pësuar dëme të jashtëzakonshme. Mbyllja totale fillimisht, e pastaj hapjet e pjesshme, kanë shkaktuar probleme dhe pengesa të rënda në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në përparimin e sektorit prodhues. Si pasojë e parandalimit të përhapjes së mëtutjeshme të pandemisë, bizneset u ballafaquan me humbje milionëshe, e një pjesë e tyre edhe me mbyllje totale.

Të gjitha këto vështirësi, kanë bërë të paevitueshme përfshirjen e një mase të tillë në Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Për nga shumta e parave të alokuara, Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit si masë e dytë e kësaj pako, është e dyta për nga madhësia, me gjithsej **108 milionë Euro**.¹ Kjo shumë e të hollave është paraparë të ndahet në gjashtë nënmasa të cilat përfaqësojnë sektorët e përfshirë në këtë kategori. Gjashtë nënmasat e masës së dytë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë:

¹ Ministria e Financave, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 2, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/7EB4F774-43C5-4471-9942-09197BC03E4F.pdf>



NËNMASA 2.1. SUBVENCIONIMI I KREDIVE INVESTIVE

Çfarë janë kreditë investive?

Kreditë investive janë financime të cilat mundësojnë hapjen e një biznesi, investim në biznesin aktual, zgjerim të biznesit, blerje të objekteve, apo edhe rinovim të biznesit. Këto kredi janë një mundësi e rivitalizimit dhe rikthimit në normalitet, për shkak se përmes tyre mund të financohen rihapje të bizneseve, rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendet e punës apo edhe hapja e një biznesi të ri. Prandaj për nga rëndësia dhe funksioni, kreditë investive janë një opsion për bizneset që synojnë rikuperimin nga pandemia.

Kreditë investive janë të rëndësishme së veçantë sa i përket zhvillimit ekonomik dhe avansimit të bizneseve. Kjo pasi që përmes investimit që bëhet nga sigurimi i fondeve përmes kredive investive, krijohet qëndrueshmëri më e madhe për biznesin, rriten të hyrat, sigurohen punëtorët dhe zhvillohen kapacitetet. Prandaj, një ndihmë e tillë është e mirëpritur, sepse mund të lehtësojë dhe në të njëjtën kohë të zhvillojë ekonominë e biznesit por edhe të vendit.

Gjatë periudhave të vështira ekonomike, kreditë për bizneset janë të një rëndësie të veçantë, pasi që krijojnë kushte për zhvillim ekonomik dhe rikthim të humbjeve. Kreditë investive mundësojnë qarkullimin e parasë, investime të ndryshme dhe forcim të stabilitetit financiar. Prandaj përmes nënmasës së parë të masës së dytë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, tentohet ofrimi i ndihmës për bizneset në këtë drejtim. Gjithsej janë **30 milionë Euro** të ndara për këtë nënmasë.

Kategoritë përfituese të kësaj mase janë:

- Bizneset që synojnë zgjerimin e kapaciteteve aktuale
- Bizneset në pronësi të grave
- Bizneset që kanë ruajtur numrin e punëtorëve, por që kanë pasur humbje financiare

Kjo nënmasë është mjaft efektive për bizneset përfituese, pasi që mundëson subvencionimin e 20% të kryegjësë, ku 10% subvencionohet në fillim duke mundësuar një grejs periudhë fillestare, e cila i'u mundëson bizneseve të zhvillohen dhe të gjenerojnë të hyra, duke mos e pasur ngarkesën e kthimit të kredisë, ndërsa 10% tjetër do të subvencionohet në fund nëse përmbushen investimet e parapara. Kjo nënmasë do të kishte pasur mundësi të dizajnohej ndryshe, sikur për shembull të sigurohej mbulimi i interesit për kredi afatshkurte. Por kjo do të paraqiste probleme për bizneset pasi që do të shtohet presioni i kohës, dhe do të rritej kësti i kredisë, e në të njejtën kohë Qeveria e Republikës së Kosovës do të kishte probleme më të mëdha sa i përket subvencionimit.

NËNMASA 2.2. MBËSHTETJE BIZNESEVE PËR QASJE NË FINANCA

Kjo nënmasë, do të tentojë të lehtësojë arritjen e bizneseve deri tek fondet të cilat garantojnë investime. Në kuadër të kësaj, kjo nënmasë do të tentojë që të mbështetë kapitalin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), duke rritur kapitalin e këtij institucioni për **40 milionë Euro**, ku përmes këtij veprimi do të hapet rruga për garantimin e 120 milionë Eurove kredi të tjera për bizneset. Por kjo nënmasë përfshin edhe **3 milionë Euro** të tjera, të cilat sipas Qeverisë së Republikës së Kosovës, do t'i hapin rrugë edhe për 86 milionë Euro të tjera të kredive të garantuara. Pra në total, kjo masë ka të alokuara **43 milionë Euro**.

Por, çka është Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)?

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është institucion i pavarur që lëshon garanci institucioneve financiare për mbulimin e rrishtit për kreditë e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të). Ky institucion krijon siguri dhe lehtësime për qasje në financa të bizneseve që i përkasin këtyre kategorive. Andaj ndihma e kësaj nënmasë për fondin në fjalë, do të mundësojë rritjen e kapaciteteve dhe rrjedhimisht më shumë hapësirë për bizneset dhe për qasjen e tyre në këtë garanci që ofron FKGK. Mbështetja e FKGK-së me 43 milionë Euro, paraqet impakt direkt në ekonominë qarkore, pasi që rritet mundësia e fondit që të ofrojë ndihmë tek bizneset në nevojë, e poashtu shtohet shpresa e bizneseve për të kërkuar ndihmë tek ky fond. Në të njejtën kohë kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm, duke ofruar më shumë opsione për rimëkëmbjen e bizneseve.

Kategoritë përfituese të kësaj mase janë:

- Ndërmarrjet mikro
- Ndërmarrjet e vogla
- Ndërmarrjet e mesme

NËNMASA 2.3. —————> INVESTIME NË TI DHE INOVACION

Transformimi digjital e bën një biznes më efikas dhe fitimprurës, në momentin kur ekzekutohet në mënyrë korrekte. Teknologjia mund të përshpejtojë proceset, të sigurojë mënyra të reja për të arritur tek klientët dhe të bëjë më të lehtë përshtatjen me ndryshimet e tregut. Fatkeqësisht, pak kompani i kuptojnë këto përfitime pasi shumica e projekteve të transformimit digjital dështojnë. Nevoja për transformim dhe përparim vërehet edhe tek bizneset kosovare, pasi është teknologjia ajo që po evulon dita ditës dhe kushtet që kjo kategori i ofron bizneseve janë të shumta.

Çka është transformimi digjital dhe për çka shërben?

Transformimi digjital shfrytëzon teknologjinë për të ndryshuar mënyrën e të bërit biznes. Është një ndryshim kulturor në mënyrën se si bashkëveproni me klientët tuaj. Kompanitë që i nënshtrohen një transformimi digjital të biznesit do të:

- Integrojnë teknologjinë digjitale në çdo aspekt të biznesit të tyre
- Ndryshojnë mënyrën e funksionimit të tyre duke modifikuar ose krijuar procese të reja dhe përvoja të reja për klientët
- Bëhet nxitja e një kulture që përfaqëson inovacionin dhe ndryshimin

Duke parë se një transformim i tillë do të lehtësojë dhe në të njëjtën kohë do të inovojë një sektor shumë të rëndësishëm të ekonomisë, ndihmesat për këtë kategori janë të mirëpritura.

7 milionë Euro do të dedikohen për këtë kapitull teknologjik, e që synon të ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme drejt tranzicionit të teknologjisë digjitale. Ndërsa në total kjo nënmasë ka **10 milionë Euro**, ku pjesa e mbetur, pra **3 milionë Euro** do të investohet në parkun e inovacionit dhe trajnimeve, që ndodhet në Prizren. Andaj inkurajohen bizneset që kategorizohen të vogla dhe të mesme që të aplikojnë për këtë ndihmesë, pasi që epoka e digjitalizimit është një e ardhme e pashmangshme, e cila do të krijoj benefite për bizneset por edhe klientët, ku lehtësohet puna e në të njëjtën paralele, rritet produktiviteti dhe efikasiteti i biznesit.

Kategoritë përfituese të kësaj mase janë:


- Bizneset e vogla
- Bizneset e mesme
- Parku i inovacionit dhe trajnimeve në Prizren

NËNMASA 2.4. —————> MBËSHTETJA E EKSPORTIT

Tregtia e mallrave në vitin 2020 ishte në vlerë prej 2.8 miliardë Euro, që tregon për një deficit tregtar për 9.4% më të ulët, krahasuar me vitin 2019. Totali i eksporteve për vitin 2020 ishte 474.8 milionë Euro. Flukset tregtare të mallrave ranë konsiderueshëm në vitin 2020, pasi COVID-19 ndërpreu aktivitetin ekonomik jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë botën. Ekzistojnë disa shkakhtar të cilat kanë ndikuar në këtë rënje. Mbyllja totale dhe e pjesshme e aktiviteteve ekonomike, mbyllja e kufijve dhe ndërpreja e lëvizjes së lirë e qytetarëve, masat parandaluese të përhapjes së pandemisë si dhe reduktimi i punës së shumë prodhuesve, importuesve dhe eksportuesve ka sjellur në pah zvogëlimin e deficitit tregtar në mbarë globin.

Deri në muajin gusht të vitit 2021, eksporti i mallrave ka arritur vlerën totale prej 406.8 milionë Euro. Krahasuar me periudhën e njejtë, pra deri në muajin gusht të vitit 2020, ku eksporti i mallrave kishte arritur vlerën prej 255.4 milionë Euro, ka një rritje prej 59.27% të vlerës së mallrave të eksportuar. Një rritje e tillë ndodhi si shkak i hapjeve graduale, dhe i rikthimit të ngadalshëm në normalitet. Ndërsa nëse krahasojmë këto të dhëna, me të dhënat e periudhës së njejtë të vitit 2019, ku eksporti i mallrave kishte arritur vlerën prej 218.1 milionë Euro, kemi një rritje prej 86.51%. Këto shifra tregojnë për një vit më të suksesshëm sa i përket eksportit, krahasuar me vitet e më hershme. Andaj mbështetja për këtë sektor, për zhvillim të mëtejshëm do të sillte benefite edhe më të mëdha për ekonominë e përgjithshme.

Eksporti i Mallrave - Për periudhën janar-gusht 2019-2021





Eksportimi i mallrave kosovare gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019, tregon se është një rritje vjetore për 23.8%, rritje e cila paraqet bilanc negativ tregtar të Kosovës, pasi që impporti është shumë herë më i lartë. Kategoritë të cilat kanë ndikuar në këtë rritje janë:

- artikuj të ndryshëm të prodhuar
- produkte të industrisë kimike
- produkte bimore
- tekstil dhe artikuj tekstili
- metale bazë dhe artikuj prej tyre
- mjetet e transportit
- plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre etj.

Prodhimi dhe eksporti, si kategori kryesore të fuqizimit të ekonomisë së një vendi, përpos ndihmës financiare që i japin vendit, krijojnë shumë pozita pune dhe ofrojnë qarkullim monetarë gjatë secilës periudhë të vitit. Andaj për të ruajtur dhe forcuar ndikimin e kësaj kategorie në zhvillimin ekonomik dhe fushave tjera, në Pakon e Ringjalljes Ekonomike përfshihet nënmasa e katërt e masës së dytë, e quajtur Mbështetja e Eksportit, e cila në vete mban gjithsej **10 milionë Euro**.

Mallrat e prodhuara në vendin tonë dhe produktet të cilat prodhuesit vendorë tentojnë eksportimin e tyre në tregun e jashtëm, kanë nevojë për prezantim dhe prezantim tek qytetarët. Andaj kjo masë synon që përmes kësaj shume të ndarë për këtë sektor, të ndihmohet pjesëmarrja në panairë jashtë Kosovës. Përpos kësaj asistence, do të tentohet edhe mbështetja në dizajnimin dhe marketingun e produkteve vendore. Kjo masë ka pasur hapësirë të planifikohet në atë mënyrë që shuma e ndarë të alokohet në blerjen e pajisjeve prodhuese, lirimit nga tarifatat doganore, dhe investimeve në efikasitet të energjisë elektrike për këto biznese. Ndër të tjera, ofrimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe furnizimit të sigurt me energji elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtrishme të energjisë, do të konkretizonte një masë e cila do të kishte ndikim më pozitiv tek kjo kategori e sektorit ekonomik.

Kategoritë përfituese të kësaj mase janë:

- Bizneset prodhuese
- Bizneset eksportuese

NËNMASA 2.5. —————> RINGJALLJA E FSHATIT PËRMES BUJQËSISË DHE AGRO-TURIZMIT

Vendi ynë ka hapësira të mëdha për të u shfrytëzuar për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Si një sektor i cili prekë shumë familje dhe i cili ndihmon zhvillimin ekonomik të gjithëmbarshtëm, bujqësia ka qenë dhe ende mbetet sektor shumë i rëndësishëm i ekonomisë kosovare. Gjatë vitit 2020, vit i cili vështirësoi punën e secilit sektor, e po ashtu edhe të bujqësisë në Kosovë, u shfrytëzuan 188.371,71 hektarë. Nga kjo shifër, pjesa më e madhe e tokave u shfrytëzua për mbjelljen e drithërave.

Agro-turizmi është një nëngrup i një industrie më të madhe, i quajtur turizëm rural që përfshin vendpushimet, tregjet e fermerëve jashtë vendit, turne bujqësore jofitimprurëse dhe biznese të tjera të kohës së lirë dhe mikpritjes që tërheqin vizitorë në fshat. Aktualisht edhe ky sektor ka filluar zhvillimin në Kosovë, dhe mbyllet e shkakuara gjatë vitit 2020, ndikuan negativisht në të hyrat e synuara dhe në numrin e turistëve që parashihej të vizitonin këto vende. Si dy sektorë shumë parësor për ekonominë e vendit tonë, edhe bujqësia edhe agro-turizmi ndihmojnë në zhvillimin e fshatit dhe në rimëkëmbjen pas dëmeve nga pandemia COVID-19. Andaj nënmasa e pestë e masës së dytë, parashihet të ndihmojë sado pak këto kategori, dhe shumë e paramenduar është **10 milionë Euro**. Ndihma do të ofrohet përmes krijimit të infrastrukturës dhe mbështetjes për investime të mëtutjeshme.



NËNMASA 2.6. —————> **RIKUPERIMI I HOTELERISË DHE BIZNESEVE TË** **MBYLLURA**


Sipas të dhënave të siguruar nga institucioni i cili ka për bazë të punës statistikak në veprimtari të ndryshme të cilat operojnë në Kosovë, pra Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë gjithsej 465 ambiente akomoduese në territorin e vendit tonë. Prej tyre 215 janë hotele sipas të dhënave në tremujorin e parë të vitit 2020. Ndërsa në tremujorin e fundit të vitit 2020, në Kosovë kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 206 hotele. Me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë, ofruesit e këtyre shërbimeve kanë qenë të mbyllura. Mbyllja e tillë ka qenë deri në qershor të vitit 2020, ku pastaj ka filluar hapja graduale, duke respektuar masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sa i përket të hyrave, mbylljet e shpeshta dhe kufizimet e tjera në sektorin e hotelerisë kanë pasur ndikim negativ me 81-90% ulje, ku vërehet sektori i akomodimit me 28%. Përpos ndikimit financiar dhe të hyrave, sektori në fjalë ka paraqitur rrezik edhe për punëtorët që zhvillojnë aktivitetin e tyre në këtë veprimtari, pasi që u është rrezikuar vendi i punës ose edhe e kanë humbur atë. Këto biznese rezultojnë me 30% të stafit që ka hasur në një rrezik të tillë. Kjo përçindje ka ardhur si rrjedhojë e vështirësisë së punëdhënësve për përmbushjen e obligimeve financiare ndaj punëtorëve të tij.



Krahasimi mes vitit 2019 dhe 2020 është një pasqyrë reale e ndikimit të pandemisë COVID-19 në sektorët e lartëpërmendur. Gjatë vitit 2019, rreth 28% kanë realizuar të hyra mbi 300.000€, ndërsa viti 2020 rezulton me 34% të bizneseve që i përkasin këtij sektori, të cilët kanë rezultuar të hyra jo më të mëdha se 50.000€. Në total duke mbledhur të dhëna dhe statistika që përfshijnë gjithë sektorin, rezulton se viti 2020, dhe paraqitja e pandemisë kanë shkaktuar humbje prej 74.84% krahasuar me vitin 2019. Gjashtëmujori i parë i vitit 2020, ka pasur 59,660 vizitorë në sektorin e hotelerisë, ndërsa gjashtë mujori i parë i këtij viti, pra 2021, ka pasur 130,332 vizitorë. Pra vërehet një rritje prej 118.45%. Një statistikë e tillë ngërthen në vete, humbjet dhe dëmet që pandemia COVID-19, dhe masat parandaluese të përhapjes së saj, kanë shkaktuar tek ky sektor.

Numri i vizitorëve në TM1 dhe TM2 për tre vitet e fundit në Kosovë



Dëmet dhe humbjet për këto veprimtari mjaft të rëndësishme, synohet të rikuperohen gjatë periudhave në vazhdim. Tanimë ky sektor funksionon me masa të cilat tentojnë parandalimin e shpërndarjes së mëtutjeshme të pandemisë dhe në të njejtën kohë parashihet të ndihmohet edhe nga Pako e Ringjalljes Ekonomike. Një masë e tillë ka të ndara 5 milionë Euro, dhe qëllimi i tyre është mbështetja për rimëkëmbje dhe shlyerje të detyrimeve që këto biznese kanë ndaj shtetit dhe bankave. Po ashtu bizneset që janë mbyllur, e që momentalisht nuk ka të dhëna të sakta rreth numrit të tyre, janë të përfshira në këtë kategori e cila do të ndihmohet. Modelimi i nënmasës së fundit të masës së dytë, do të mund të fokusohet tek lirimi i detyrimeve që i kanë shtetit bizneset që janë mbyllur dhe që kanë pësuar më së shumti nga pandemia COVID-19. Në të njejtën kohë bizneset do të inkurajoheshin të ringjallen dhe të ndihmojnë ekonominë e vendit. Kjo masë do të paraqiste kosto më të madhe për buxhetin e Republikës së Kosovës, por do të ishte më efektive dhe më e mirëpritur nga ana e bizneseve që përfshihen në këtë kategori.

REKOMANDIME

- Kreditë investive të parapara me nënmasën 1 të masës së 2-të duhet të subvencionojnë edhe kategori të tjera të grupeve shoqërore të cënueshme siç janë personat me aftësi të kufizuara. Për më tepër, nënmasa duhet të përkrah bizneset që janë të pajisur me çertifikatë konformiteti me standardin ISO 14001 për Sisteme të Menaxhimit Mjedisor dhe që aplikojnë masa të efijencës së energjisë dhe burimet e ripërtrishme.
- Nënmasa 2.2 për mbështetje të bizneseve për qasje në financa do të duhej të shoqërohej me një monitorim më të thuktë të Qeverisë ndaj Fondit. Vëmendje e veçantë do të duhej t'i ofrohej lehtësimit të marrjes së kredive për biznese të gjelbra ose biznese që transformojnë proceset e brendshme për të reduktuar ndotjen apo për të ndryshuar sistemet energjetike. Një raportim i rregullt i FKGK-së duhet të vihet në praktikë në mënyrë që të rritet transparencja dhe llogaridhënja.
- Rekomandojmë që pjesa prej 3 milionë eurove të parapara për parkun e inovacionit dhe trajnimeve në Prizren të jepet me thirrje të hapur dhe jo të parashihet me Ligj të ndarjeve buxhetore. Karakteri kompetitiv i pakos së rimëkëmbjes duhet të ruhet dhe kësioji të nxitet zhvillimi dhe rimëkëmbja duke rritur konkurrencën, cilësinë dhe meritokracinë në alokimin e fondeve publike.
- Në pjesën e mbështetjes së eksportit, ne konsiderojmë që kjo masë është një rast i mirë që të vendoset një sistem i kontrollimit të emetimeve të dioksid karbonit. Bizneset me produkte që janë më pak intenzive për nga lirimi i ndotësve në atmosferë, duhet të incentivohen më shumë. Kjo masë, kështu do të shërbente si një hap i parë për përgatitjen e Kosovës për një sistem të taksimit të karbonit, jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e agjendës së gjelbër.
- Masa prej 10 milionëve për agroturizmin duhet të shoqërohet me politika të tokës dhe politika tatimore për tokat e pashfrytëzuara.





“Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.”